



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA PUKË  
Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Administrimit të Territorit

Nr. 397 prot.

Pukë, më 2005 2022

**PROJEKT-VENDIM**

Nr. 1, Datë 2005 /2022

**PËR  
NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.47, DATË 17.12.2004”, PËR EMËRTIMIN E  
RRUGËVE, SHESHEVE DHE INSTUCIONEVE TË BASHKISË PUKË”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, nën pika 1.7, shkronja “b”, nenit 54, shkronja “ll” dhe nenit 55, pika 2 dhe 6 të Ligjit nr.139/2015 “Për vetë qeverisjen vendore”(i ndryshuar); si dhe neni 2 pika 1(ç), neni 3, neni 5 pika 1, nenit 7, neni 25, nenit 26, të Ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave”(i ndryshuar); Ligjit nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, (i ndryshuar), VKB-së nr.47, datë 17.12.2004 “Për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe instucioneve të Bashkisë Pukë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak pasi mori në shqyrtim kërkesën,

**VENDOSI:**

1. Në pikën 3 të VKB-së nr.47, datë 17.12.2004 “Për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe instucioneve të Bashkisë Pukë”, shtohet **germa gj**) Për emërtim rruge “Ndue Marinaj”, fshati Kçirë në Njësinë Administrative Luf-Qerret sipas fragmentit të hartës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Çdo vendim i mëparshëm që bie në kundërshtim me pikën 1 të këtij vendimi, shfuqizohet.
3. Ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Administrimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër.

Hartuesi  
Drejtori i Zhvillimit Ekonomik  
Dhe Administrimit të Territorit

Alda Mema

Juristi

Endrit Kraja

KRYETARI  
GJON GJONAJ



**RELACION  
PËR  
PROJEKT-VENDIMIN PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.47, DATË 17.12.2004”,  
PËR EMËRTIMIN E RRUGËVE, SHESHEVE DHE INSTUTICIONEVE TË BASHKISË  
PUKË”**

**Drejtuar: Këshillit Bashkiak**

**Të nderuar Këshilltare/Keshilltarë**

Në mbështetje të ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) dhe të ligjit nr. 9270/2004 “Për sistemin e adresave” (i ndryshuar), lind nevoja e emërimit të rrugëve të pa emërtuara në territorin e Bashkisë Pukë apo dhe ndryshimin e disa emërtesave me propozim të banorëve të zonës dhe dijeninë e njësisë administrative, ku një ndër këto është rruga që kalon në fshatin Kçirë, lagjja Pla (sipas fragmentit të hartës bashkëlidhur), që aktualisht mban emrin në sistemin e adresave “Luf Pla”.

Për riemërtimin e kësaj rruge, propozohet emri “Ndue Marinaj”, një drejtues i nderuar dhe i vlerësuar. Është me rëndësi të madhe, që njerëz të tillë të mos lihen në harresë, por të kujtohen me nder për kontributin e vlerat e treguara gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Z. Ndue Marinaj ka dhënë një kontribut të madh në zhvillimin e zonës si dhe përkushtim në shërbim të shtresave në nevojë, i cili gëzon titullin “Qytetar Nderi” i Bashkisë Pukë me motivacionin “Në vlerësim dhe nderim të thellë për përkushtimin maksimal, devotshmërinë e pashembullt në shërbim të shtresave në nevojë si drejtues dhe misionar pararojë në menaxhimin e situatave të vështira të emergjencave civile dhe kontributeve në fushën arkitekturore si zbatues i disa projekteve në territorin e Bashkisë Pukë” sipas VKB nr. 4 datë 26/03/2020.

Z. Ndue Marinaj lindi në fshatin Kçirë 29.05.1971 dhe ndërroi jetë si pasojë e Covid-19 në datë 24.03.2020.


Nisur nga faktet e sipërcituara kërkojmë nga ana juaj të miratohet projekt-vendimi “Për një shtesë në vendimin nr.47, datë 17.12.2004”, për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe instuticioneve të Bashkisë Pukë”.

Ju faleminderit!




**Hartuesi  
Drejtori i Zhvillimit Ekonomik  
dhe Administrimit të Territorit  
ALDA MEMA**




# HARTA TREGUESE E RRUGES 'LUF-PLA' EKZISTUESE




**Legjenda**

-  Rruga\_Nacionale\_SH5
-  Rruga 'Luf-Pla'
- 




Coordinate System: ETRS 1989 Albania 2010  
 Projection: Transverse Mercator  
 Datum: ETRS 1989  
 False Easting: 500,000.0000  
 False Northing: 0.0000  
 Central Meridian: 20.0000  
 Scale Factor: 1.0000  
 Latitude Of Origin: 0.0000  
 Units: Meter

1:8,000




Punoi: exp. GIS A. Lufi

# HARTA TREGUESE E RRUGES 'NDUE MARINAJ' E PROPOZUAR




**Legjenda**

- Rruga\_Nacionale\_SH5
- Rruga 'Ndue Marinaj'
- 



Coordinate System: ETRS 1989 Albania 2010  
Projection: Transverse Mercator  
Datum: ETRS 1989  
False Easting: 500,000.0000  
False Northing: 0.0000  
Central Meridian: 20.0000  
Scale Factor: 1.0000  
Latitude Of Origin: 0.0000  
Units: Meter

1:8,000



Punoi: exp. GIS A.Lufi